VENDIM
Nr. 28, datë 10.2.2020

MBI APLIKIMIN E SHOQËRISË "KROI MBRET ENERGJI" SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et: "BACKA 1", ME KAPACITET TË INSTALUAR 1600 kw; "BACKA 2", ME KAPACITET TË INSTALUAR 4000 kw; "BACKA A", ME KAPACITET TË INSTALUAR 500 kw; "BACKA B", ME KAPACITET TË INSTALUAR 500 kw; "BACKA C", ME KAPACITET TË INSTALUAR 720 kw, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 7320 kw

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "a", nenit 5, pika 1, germa "a" dhe nenit 13 dhe 14, pika 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, dhe nenit 15, të "Rregullores të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.2.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 28/5 prot., datë 4.2.2020, mbi licencimin e shoqërisë "Kroi Mbret Energji" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 178, datë 14.11.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë "Kroi Mbret Energji" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- Në vijim të vendimmarrjes, ERE, me shkresën nr. 32/51 prot., datë 18.11.2019, ka bërë publikimin në medien e shkruar, në lidhje me fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: "Backë–Staraveckë" dhe në përfundim të afatit të njoftimit, nuk ka pasur vërejtje apo palë të interesuara.
- Me shkresën nr. 643/3 prot., datë 20.11.2019 dhe nr. 643/6 prot., datë 11.12.2019, ERE iu drejtua shoqërisë, duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar, në përgjigje të së cilës, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 6347/7 prot., datë 12.12.2019, shoqëria "Kroi Mbret Energji" sh.p.k. ka përcjellë dokumentacionin e munguar.
- Shoqëria "Kroi Mbret Energji" sh.p.k. është një subjekt tregtar i krijuar në zbatim të nenit 8 të kontratës së koncesionit dhe është regjistruar në QKB, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuara (sh.p.k.), konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", në datën 20.7.2012, me numër identifikimi (NUIS) L29326401S.
- Nga analiza e dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria "Kroi Mbret Energji" sh.p.k. rezulton se subjekti ka plotësuar pjesërisht kërkesat e "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:
  - formati dhe dokumentacioni për aplikim: neni 9, pika 1, germat "a", "b", "c": plotësuar;
  - dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor: neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "d", "e", "f", "g": plotësuar;
  - dokumentacioni financiar dhe fiskal: neni 9, pika 3, germat "a", "b", "c", "d": plotësuar;
  - dokumentacioni teknik për HEC-in: neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, germat "a", "b", "c", "d" dhe pika 4.1.4, germat "a", "b", "c", "d", "e": plotësuar;
  - leje nga institucione të tjera: neni 9, pika 4.1.5, germat "a", "b", "c": plotësuar pjesërisht.

Mungon germa "b" (Leja përdorimit të ujit). Shoqëria duhet të depozitojë në ERE lejen e përdorimit të burimit ujor përpara fillimit të operimit të veprimtarisë.

- Shoqëria "Kroi Mbret Energji" sh.p.k. ka paraqitur kontratën e koncesionit nr. 1616 rep., nr. 374 kol., datë 26.6.2012, të lidhur midis palëve: koncesionarit "Alba Konstruksion" sh.p.k. dhe METE-s, me cilësinë e autoritetit kontraktues, "Për ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentraleve "Backa 1", "Backa 2", "Backa A", "Backa B", "Backa C", me përfundimin e periudhës së përcaktuar në kontratën e koncesionit tek autoriteti kontraktues.

- Kontrata e koncesionit ka një kohëzgjatje prej 35 vjetësh, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të saj. Koncesionari merr përsipër të vërë në punë hidrocentralin brenda 15 muajve, nga data e hyrjes në fuqi të kontratës së koncesionit.

- Shoqëria ka paraqitur në ERE, kontratën e qirasë për përdorimin e fondit pyjor dhe kullosor publik, nr. 3487 prot., datë 20.11.2018, të lidhur midis palëve: Bashkia Skrapar, në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqëria "Kroi Mbret Energji" sh.p.k., në cilësinë e qiramarrësit, për një afat njëvjeçar, e cili fillon nga dita e nesërme e nënshkrimit të saj. Gjithashtu, ka paraqitur në ERE kontratën e rinovuar të qirasë, me numër 4297 prot., datë 10.12.2019, për një afat njëvjeçar, me të drejtë rinovimi, duke filluar nga e nesërmja e nënshkrimit të kësaj kontrate.

- Shoqëria "Kroi Mbret Energji" sh.p.k., me shkresën nr. 5612 prot., datë 28.3.2017, i është drejtuar OSHEE sh.a., me kërkesën për miratimin e pikës së lidhjes së kaskadës së HEC-eve: "Backa 1", "Backa 2", "Backa A"; "Backa B" dhe "Backa C".

- Referuar kërkesës së sipërcituar, OSHEE sh.a., me shkresën nr. 812/5 prot., datë 25.4.2018, drejtuar shoqërisë "Kroi Mbret Energji" sh.p.k., i konfirmon "Miratimin e pikës së lidhjes së HEC-eve: "Backa 1" ,"Backa 2" ; "Backa A"; "Backa B" dhe "Backa C", e cila do të lidhet në rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet zbarave 10 kV, të nënstacionit 35/10 kV Çorovodë e Re. Lidhja e kaskadës së HEC-eve: "Backa 1" ,"Backa 2", "Backa A", "Backa B" dhe "Backa C", me linjën 35 kV në zbarat 10 kV, do të realizohet nëpërmjet një transformatori zbritës 35/10 kV që do të vendoset pranë nënstacionit Çorovodë e Re.

- Shoqëria ka paraqitur në ERE vërtetimin e lëshuar nga Agjencia e Ujit, të Basenit Seman, nr. 442 prot., datë 9.11.2011, për pajisjen me lejen e ujit, të shoqërisë "Alba Konstruksion" sh.p.k.

Gjithashtu, me shkresën nr. 634/7, datë 13.2.2019 (plotësim dokumentacioni), ajo ka depozituar në ERE vendimin nr. 16, datë 15.9.2010, të lëshuar nga Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman, "Për miratimin në parim të kërkesës, për përdorimin e rezervave ujore me koncesion, për prodhim hidroenergjie në H/C, nga përroi i Straveckës në Skrapar". ERE, me shkresën nr. 634/8 prot., datë 20.12.2019, i është drejtuar Këshillit të Basenit Ujëmbledhës Seman, lidhur me rikonfirmimin ose ndryshimin e vendimit nr. 16, datë 15.9.2010, "Për miratimin në parim të kërkesës, për përdorimin e rezervave ujore me koncesion, për prodhim hidroenergjie në H/C, nga përroi i Staraveckës në Skrapar". Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman, i është përgjigjur ERE-s me shkresën nr. 34 prot., datë 13.1.2020, në të cilën ndër të tjera citohet: "Në bazë të verifikimit të kryer, subjekti nuk është i pajisur me leje dhe se miratimi në parim nuk mund të konsiderohet si leje finale. Mbështetur në VKM-në nr. 416, datë 25.5.2015, subjekti duhet të aplikojë pranë ZABU-së, për pajisjen me lejen e përdorimit të burimit ujor".

- Shoqëria ka përcjellë në ERE Deklaratën Mjedisore, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, shkresë nr. 15 prot., datë 23.2.2015, me nr. 77, identifikim dhe nr. 08 vendimi, për personin juridik "Kroi Mbret Energji" sh.p.k., "Për të zhvilluar projektin kaskadë hidroenergjetike Backë–Staraveckë (HEC A, HEC C, HEC B, HEC 1, HEC 2), komuna Potom dhe Qendër, rrethi Skrapar, qarku Berat. Kjo deklaratë është e vlefshme, pasi veprimtaria të licencohet nga institucionet e tjera. Mosfillimi i aktivitetit brenda një periudhe dyvjeçare, sjell për pasojë pavlefshmërinë e deklaratës për ushtrim e këtij aktiviteti. Aktualisht rezulton sipas deklarimeve se vepra ka përfunduar së ndërtuari.

- Aplikuesi deklaron se ka filluar punimet për ndërtimin e veprës në muajin gusht 2018 dhe përfundoi punimet në tetor 2019. Referuar fuqisë juridike të Deklaratës Mjedisore, subjekti duhej të kishte filluar punimet, jo më vonë se data 23.2.2017, që ky dokument të përmbushte qëllimin për të cilin është lëshuar.

- Sa më sipër, subjekti nuk ka bërë me dije nëse Deklarata Mjedisore i është nënshtruar procesit të rinovimit apo është pajisur me një deklaratë të re mjedisore, fuqia juridike e së cilës të shtrihej përgjatë periudhës gjatë së cilës është ndërtuar vepra.

- Neni 14, pika 3, e "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", parashikon se: "Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit të përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shume se 30 ditë pune.

- Me qëllim sqarimin e afateve të shtrirjes së fuqisë juridike të Deklaratës Mjedisore për këtë aplikim, është e nevojshme që të saktësohet statusi i saj më organin përgjegjës.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shtyjë për një afat prej 20 ditëve pune, shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Kroi Mbret Energji" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: "Backa 1", me kapacitet të instaluar 1600 kw; "Backa 2", me kapacitet të instaluar 4000 kw; "Backa A", me kapacitet të instaluar 500 kw; "Backa B", me kapacitet të instaluar 500 kw dhe "Backa C", me kapacitet të instaluar 720 kV, me kapacitet total 7320 kw, për një afat 28 vjet e 5 muaj.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet në ERE rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti